

EKONOMIA

Trevat shqiptare, për nga niveli i përgjithshëm i zhvillimit ekonomik cilësohen si vende bujqësore industriale. Kjo do të thotë që ekonomia bujqësore luan rolin kryesor në zhvillimin ekonomik të tyre. Kemi 3 sektorë kryesorë të ekonomisë.

Bujqësia në 6 njësitë administrative

1) Bashkia Korçë

1. Sektori i parë ka bazë **ekonominë bujqësore**.

Historikisht, bujqësia në Korçë ka qenë mbështetja kryesore e qarkut me tregtinë e bërë me qytetet e tjera të mëdha në Shqipëri apo vendet përreth. Qyteti rrethohet nga tokë bujqësore pjellore dhe shtrihet pranë kufijve me Greqinë dhe Maqedoninë.

- *Pozita e saj gjeografike* konsiderohet si një nga pikat më të forta që favorizon zhvillimin e saj ekonomik. Megjithatë, e ardhmja e zhvillimit të agrobiznesit qëndron në konceptin e zhvillimit më të gjerë ekonomik. Fakti që Korça zë vendin e dytë për nga sipërfaqja e tokës bujqësore në vend, e bën bujqësinë sektorin më të rëndësishëm në ekonominë e qarkut duke zënë rreth 32 për qind të të ardhurave të përgjithshme.
- *Veshmbathja*

Ky sektor përbën 31 për qind të ekonomisë së qarkut, një shifër pothuajse e njëjtë me sektorin bujqësor. Megjithatë, prodhimi i veshmbathjeve është sektori më i madh përsa i përket numrit të ndërmarrjeve dhe punonjësve (midis 4,500 dhe 5,000 punonjës, kryesisht gra). Në më të shumtën e rasteve, ndërmarrjet janë sipërmarrje të përbashkëta (joint ventures) të realizuara nga biznesmenë shqiptarë dhe grekë. Lënda e parë për bizneset shqiptare importohet që të prodhohen artikujt përfundimtarë.

- *Agrobiznesi*

Qarku i Korçës është streha e njërit prej grupeve më të mëdha të bizneseve të përpunimit ushqimor në vend: prodhimi i mishit, sallame, produkte bulmeti, pije alkoolike dhe joalkoolike, si edhe rritja e kërminjve, etj. Gjatë viteve të fundit, numri i bizneseve agro—përpunuese është rritur vazhdimisht dhe ky sektor është bërë një punëmarrës shumë i rëndësishëm në bashki. Bizneset e rinj përpunojnë fruta, perime, produkte bulmeti, verë, vaj, lule, etj, dhe pjesa më e madhe e këtyre kompanive janë NVM. Raporti i kompanive që operojnë në këtë sektor tani qëndron në 87 për qind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve në qarku, ndërkohë që numri i bizneseve që punësojnë ndërmjet gjashtë dhe dhjetë personave po rritet vazhdimisht.

2) Bashkia Devoll

Devollit kufizohet në veri me Bashkinë Pustec, në perëndim me bashkitë Maliq dhe Korçë, në jug me bashkinë Kolonjë, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Bilishtit. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Devollit dhe qarkut të Korçës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 44 fshatra.

Bashkia e Devollit është një zonë që dominohet nga popullsia fshatare, *sigurimi i të ardhurave të të cilës mbështeten në dy burime kryesore, bujqësia dhe blegtoria*. Shumë zona të Devollit kanë pësuar zhvendosje masive të popullsisë ku banorët kanë braktisur totalisht fshatrat e thellë për t'u vendosur në zona më afër qytetit duke u fokusuar tek puna në bujqësi për shkak se toka është produktive. Përveç kultivimit të kulturave të ndryshme, si të lashtat dhe perimet, banorët merren shumë me pemëtarinë duke qenë ndër zonat me prodhim më të lartë në vend. Blegtoria është një tjetër aspekt përmes të cilës banorët gjenerojnë të ardhura, por kjo ka mbetur në nivelin e bizneseve familjare. Burimi kryesor i punësimit në Devoll është bujqësia, në një masë ndjeshëm më të lartë se mesatarja në shkallë vendi; shërbimet përbëjnë burimin e dytë kryesor, por në një masë ndjeshëm më të ulët se mesatarja në shkallë vendi, ndërsa industria është në tërësi pak e zhvilluar në zonë.

Bujqësia është një nga bazat e zhvillimit ekonomik të zonës në afatgjatë.

o Toka bujqësore shfrytëzohet nga fermerët duke ruajtur dhe rritur rendimentit të saj.

o Toka bujqësore shfrytëzohet në bazë të avantazheve krahasuese.

o Nxitje e bashkëpunimit mes fermerëve.

o Nxitje e sipërmarrjes privatë në industrinë e përpunimit ushqimor.

Në bashkinë Devoll ushtrojnë aktivitet rreth 8,300 ferma bujqësore me sipërfaqe mesatare toke rreth 1 ha. Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore është rreth 12,642 ha, nga të cilat 1,920.5 ha janë tokë e papunuar, pra aktualisht në zonë shfrytëzohet për prodhim dhe të ardhura rreth 85 % e tokës bujqësore. Kjo do të thotë se shfrytëzimi i saj në drejtim vetëm të sipërfaqes është i kënaqshëm.

Bashkia Devoll	Bilisht	Qendër	Progër	Hoçisht	Miras
Sipërfaqe tokë bujqësore ha	842	3200	1700	3000	3900
Sipërfaqe tokë bujqësore e punuar ha	693	2769	1544	2524	3192
Sipërfaqe tokë bujqësore e pa punuar ha	150	431	156	476	708
Tokë bujqësore e shfrytëzuar	82%	87%	91%	84%	82%
Niveli i punësimit në bujqësi					56.1%

3) Bashkia Kolonjë

Burimi kryesor i të ardhurave të banorëve është *bujqësia dhe pemëtaria*. Kulturat më fitimprurëse janë drithërat (gruri, misri) e pemët frutore (molla). Shtimi i prodhimit bujqësor në çdo drejtim potencial kushtëzohet nga gjendja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e cila, aktualisht mundëson ujitjen e vetëm 40% të sipërfaqes së tokës gjithsej, shkallës së ulët të mekanizimit të punës për disa nga proceset e punës në bujqësi, dhe kapaciteteve magazinuese të pamjaftueshme të prodhimit të secilës prej kulturave më të kultivuara në zonë. Toka bujqësore është tejet e fragmentarizuar ndërsa mungojnë bashkëpunimet mes fermerëve dhe politika vendore të përbashkëta për prodhimin bujqësor; zinxhiri i vlerës është i shkurtër, prodhimi grumbullohet nga sipërmarrës privatë në frigoriferë dhe mbërrin në tregjet vendore dhe rajonale, por nuk përpunohet më tej në asnjë formë. Këto probleme janë shkak për rendiment të ulët të tokës dhe për pasojë shfrytëzim të ulët të potencialit të saj. Nxjitja e bashkimit të fermerëve dhe informimi i tyre për fondet e skemave kombëtare që janë të vlefshme për sipërmarrje të përbashkëta të fermerëve është i nevojshëm për të drejtuar në mënyrë me strategjike zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

- Sipërfaqja e tokës bujqësore për Bashkinë e Kolonjës është 6357 ha. Për vitin 2015 sipërfaqja e mbjelle është 4416 ha, nga kjo pjesa më e madhe shërben për kultivimin e drithërave 10 dhe foragjereve. Numri i fermave në Bashkinë e Kolonjës është 2,303; nga këto 1420 ferma kanë madhësi ngastre 2 deri 2.5 ha.
- Mbillen drithërat e bukës, perimet e drurët frutorë (molla, kumbulla, arra, qershia, rrushi etj.) Dallohen domatja e Sanjollasit, qershia e Podës, rrushi, vera dhe rakia e Leskovikut.
- Sipërfaqja e tokës bujqësore mbetet konstatnte, ndërsa prodhimi bujqësor është i orientuar më tepër nga plotësim i nevojave të veta familjare dhe ato të blegtorisë. Tregjet kryesore të vendit mbeten ende larg, për shkak të infrastrukturës së dobët dhe kostove të larta të transportit. Mungojnë shoqatat efektive të fermerëve, që mund të rrisnin ekonominë e shkallës.

4) Bashkia e Maliqit

Burimi kryesor i të ardhurave të zonës së Maliqit është *bujqësia*. Potenciali për zhvillim të mëtejshëm të sektorit është sigurisht më i madh se sa aktualisht shfrytëzohet. Për arsye të tokës shumë të përshtatshme, kultivimi i panxharit dhe përpunimi prej tij i sheqerit kanë qenë para viteve '90 veprimtari kyçe të kësaj zone dhe me rëndësi kombëtare. Sot ky potencial është thujse i braktisur.

Shtimi i prodhimit bujqësor kushtëzohet nga gjendja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e cila, aktualisht mundëson ujitjen e vetëm 1/3 e sipërfaqes së tokës gjithsej, shkallës së ulët të mekanizimit të punës për disa nga proceset e punës në bujqësi, dhe kapaciteteve ruajtëse të pamjaftueshme të prodhimit të secilës prej kulturave më të kultivuara në zonë. Përkrah infrastrukturës, qëndrojnë mangësitë e natyrës politike. Toka

bujqësore është tejet e fragmentarizuar, me madhësi mesatare të fermës rreth 1 ha, ndërsa mungojnë bashkëpunimet

mes fermerëve dhe politika vendore të përbashkëta për prodhimin bujqësor; zinxhiri i vlerës është i shkurtër, prodhimi grumbullohet nga sipërmarrës privatë në frigoriferë dhe mbërrin në tregjet vendore dhe rajonale, por nuk përpunohet më tej në asnjë formë. Këto probleme janë shkak për rendiment të ulët të tokës dhe për pasojë shfrytëzim të ulët të potencialit të saj. Nxitja e bashkimit të fermerëve dhe informimi i tyre për fondet e skemave kombëtare që janë të vlefshme për sipërmarrje të përbashkëta të fermerëve është i nevojshëm për të drejtuar në mënyrë me strategjike zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

- *Bujqësia* është një nga bazat e zhvillimit ekonomik të zonës në afatgjatë:
 - o Toka bujqësore shfrytëzohet nga fermerët duke ruajtur dhe rritur rendimentit të saj
 - o Toka bujqësore shfrytëzohet në bazë të avantazheve krahasuese
 - o Nxitje e bashkëpunimit mes fermerëve
 - o Nxitje e sipërmarrjes privatë në industrinë e përpunimit ushqimor

Rreth 50% e prodhimitarisë bujqësore të Qarkut Korçë vjen nga territori i bashkisë Maliq. Zona është bujqësore dhe pjesërisht blegtorale. Kulturat kryesore që mbillen janë pemët frutore, kryesisht mollë, dhe qepë, patate, misër, grurë e fasule. Bujqësia punëson rreth 70% të forcës punëtore, dhe mbi këtë bazë, specializimi në industrinë përpunuese të prodhimeve bujqësore nuk mund të realizohet menjëherë.

Degët e ekonomisë/Niveli i punësimit	Bashkia Maliq	Mesatare vendi
bujqësi	65.8%	26.1%
industri	13.6%	20.4%
shërbime	20.6%	53.5%

Bashkia	Maliq
Sip. tokë bujqësore	474
Kultura të mbjella { mollë,patate,qepë,fasule }	62,350

5) *Bashkia Pustec*

Bashkia është *një njësi vendore tipike bujqësore*, edhe pse angazhimi i popullatës lokale në këtë sektor është tejet e kufizuar për shkak të një serie problemesh që manifeston ky sektori, ku ndër më kryesorët përmendim: rendimenti shumë i ulët bujqësor si pasojë e terrenit të thyer kodrinor, mungesa e vaditjes dhe aksesit i ulët në treg.

- Sipërfaqja e tokës bujqësore për bashkinë Pustec është 1405.83 ha, 97% e së cilës i është ndarë popullatës lokale. Sipërfaqja e kultivuar është 1000 ha, pjesa tjetër është e pa kultivuar.

- Struktura e tokës së punueshme dominohet nga toka arrë, dhe në një pjesë të vogël nga vreshta dhe pemëtore, sipas paraqitjes së mëposhtme grafike.
- Fshati Pustec ka sipërfaqen më të madhe të tokës arrë, ndërsa Lajthiza fshati me sipërfaqen më të vogël. Sipërfaqja më e madhe e

pemishteve shtrihet në Pustec dhe Gollomboc, ndërsa përsa i përket vreshtave, 40% e sipërfaqes së tyre është lokalizuar në Pustec. Sipërfaqen më të madhe të mbjellë e zënë drithërat e bukës, ndër të cilat gruri, foragjeret, vreshtaria, pemëtaria, perime dhe fasule dhe çaj mali. Më poshtë jepet grafiku që tregon kulturën bujqësore dhe sipërfaqen në ha të mbjellë me këto kultura.

Kultura bujqësore	Sipërfaqe ha	% në sip. totale
Gruri	318	23%
Misër, fasule	251	18%
Perime dhe patate	92	7%
Farogjere	257	18%

6) *Bashkia Pogradec*

Pogradeci në të kaluarën ka qenë një qendër e rëndësishme industriale në Shqipëri. Për tu përmendur në atë kohë janë industria e kromit, e hekurit, e nikelit, e qymyrit, e peshkimit, e përpunim drurit dhe të pijeve.

Turizmi

Plazhi e Pogradecit ndodhet brenda në qytet përgjatë shetitores "1 Maji". Është një plazh më rërë, ujë të pastër dhe mundësi për argetim. Në Pogradec ka edhe disa plazhe të tjerë private e publike, me rërë e guralece të vegjël. Jashtë qytetit janë plazhet me ujë të kristaltë të Linit dhe Tushëmishtit.

Pogradeci ka një muze të pasur me deshmi antikiteti dhe të kohës së luftës, ka kishën e vjetër ortodokse, që quhet kisha e Shën Mërisë dhe ndodhet në lagjen e vjetër të Pogradecit, si dhe një kishë të re, më arkitekturë shumë të vecante të quajtur Ringjallja. Qyteti gjithashtu ka dy xhami. Njera ndodhet në qendër të qytetit dhe tjetra në lagjen e quajtur Goricë.

Katër kilometër në lindje të Pogradecit ndodhet pika turistike të Drilonit.

Pogradeci nje vend turistik.

2. Sektori i dytë ka bazë **industrinë**

INDUSTRIA --- SEKTORI SEKONNDAR

- INDUSTRIA pas viteve '90 ka pësuar ndryshime strukturore . Deri në vitet '90 vendin kryesor të ekonomisë e zinte : industria e nxjerrjes dhe e pasurimit të hekur nikelit , e qymyrgurit , industria e lehtë ushqimore, energjitike dhe industria mekanike me uzinën e precizionit e shumë officina të tjera. Ndryshimi i sistemit ekonomik në vitet '90 dhe teknologjia jobashëkohore prodhuese e këtyre

degëve të industrisë . Në kushtet e reja industria pësoi ndryshime në përshtatje me kërkesat e tregut dhe cilesinë e prodhimit . Aktualisht ajo është e organizuar mbi bazën e ndërmarjeve të vogla dhe të mesme.

- **Industria ushqimore** mbështetet në ndëmarjet e prodhimit të verës, dhe të pijeve të tjera alkoolike dhe në punishtet e përpunimit të produkteve të ndryshme buqësore e blektorale.
- **Industria e përpunimit të drurit** bazohet në stabilitetin e përpunimit të lëndës drusore (në Malësinë e Gorë-Oparit , të Mokrës , të Soporit , të lënies , në pllajen e Kolonjës)
- **Industria e materialeve të ndërtimit** bazohet në përpunimin e gurëve të ndryshëm të ndërtimit , siç janë gurët gëlqeror ,ranore e shtufor. Materiale argjilore përdoren për prodhimin e tullave . Qytetarët korçarë përdorin shumë gurin e gdhendur , të kombinuar me drurin dhe hekurin për ndërtimin e banesave.
- **Industria tekstile dhe e veshjeve** Kjo industri tradicionale për zonën sot karakterizohet nga industria e konfeksioneve ku sot janë rreth 32 firma të tilla me investitorë vendas dhe të huaj ku punësohen rreth 3500 punonjës , kryesisht gra e vajza , prodhimet e të cilave rreth 90% eksportohen (mund të përmendim Alfansa , Gordon Star, International Korca etj.Tendenca po çojnë në rritjen e investimeve në këtë fushë dhe në degë të tjera si : filaturimi , thurja, ngjyrimin stampimi etj. Industria Minerale në rajonin e Korçës gjendet në dy vendburime qymyuri , në Mborje-Drenovë që nxjerr qymyrin me fuqi kalorike 3300-3700KKOLkg dhe ajo e Gorës me tregues kalorik 2400-3400 KKOLKG . Është dhe miniera dhe fabrika e bakrit në Rehovë me kapacitet përpunues 60000 ton në vit, si dhe miniera e hekur-nikelit- silikatit në Bitinckë. Ndërkohe në vendburimet e asbestit, talkut , gurëve dekorative e gëlqerore presin investitorët e tyre për tu vënë në efikasitet . Degë të tjera :

Sot ka marrë shtrirje të gjerë prodhimi i mobiljeve , këpucve , lëkura, punishtet e prodhimin e vetratave prej duro-alumini prodhimi i qeramikes, prodhimin i ambazhurve plastike dhe me një përdorim si ato të tetrapakut etj.

- **Industria minerare** përfaqësohet nga nxjerrja e qymyrgurit si dhe hekur-nikelit në Mborje-Drenovë, Lozhan të Korçës, Alarup të Pogradecit; Bitinckë (Devoll) dhe Guri Kuq (Pogradec); Rehova (Vithkuq) dallohet për nxjerrjen e bakrit dhe po këtu u ngrit edhe uzina e pasurimit të bakrit.
- **Industria mekanike** (1960-1990) u përfaqësua nga një sërë ndërmarrjesh të përqendruara më së shumti në qytetin e Korçës. Uzina Mekanike Bujqësore prodhonte vegla dhe pjesë këmbimi, jo vetëm për rajonin por gjithë vendin. Gjithashtu u ngrit Uzina e Preçizionit ku bëheshin veglat e dorës dhe mjetet matëse, si edhe Uzina e Stampave dhe Kushinetave. TEC-i i Korçës i ndërtuar në vitin 1970, furnizonte me avull dhe energji elektrike ndërmarrjet e mësipërme për proceset teknologjike që kryenin.
- **Industria e ndërtimit** funksiononte nëpërmjet Fabrikës së Tullave dhe Fabrikës së Fajancës, (prodhim materiale ndërtimi) ndërkohë që në qytetet Korçë, Pogradec

dhe Ersekë kishte ndërmarrje sharre për shfrytëzimin e lëndës drusore dhe ndërmarrje të prodhimit të mobiljeve.

- **Industria e transportit** përfaqësohej nga Parku i Mallrave në qytetin e Korçës, nga ku bëhëj transporti i produkteve industriale të rajonit në gjithë Shqipërinë. Zhvillim të dukshëm mori industria e tekstileve që përfaqësohej nga Kombinati Trikotazhit i njohur për prodhimet e tij të pambukta dhe të leshta në të gjithë vendin. Gjithashtu zona ishte e njohur edhe për përpunimin e lëkurëve dhe prodhimin e këpucëve nëpërmjet Fabrikës së Prodhimit të Këpucëve në Korçë dhe Pogradec. E mbështetur në traditat e hershme të artizanatit në gjithë zonat e qarkut të Korçës, industria tekstile në vitin 1968, zinte 14 % të prodhimit të përgjithshëm industrial. Ndërmarrja artizanale dallohej për prodhimet e shumëllojshme dhe me cilësi të lartë të qilimave, sixhadeve etj.
- Rol të rëndësishëm në ekonominë e rajonit dhe vendit ka luajtur **industria e përpunimit të produkteve bujqësore**, e cila përfaqësohej nga industria ushqimore që prodhonte reçelra të ndryshme, marmalatë dhe konservonte fruta dhe perime. Kjo degë ishte e zhvilluar edhe në rrethet Kolonjë dhe Pogradec. Prania e sasisë së madhe të panxharit të sheqerit, që kultivohej në fushën e Maliqit, krijoi mundësinë që në vitin 1951 të ngrihej Kombinati i Sheqerit në Maliq, i cili funksionoi deri në vitin 1996 dhe tashmë është jashtë funksionit. Në këtë kohë u ngrit dhe TEC-i i Maliqit me qëllim prodhimin e avullit dhe energjisë në funksion të kombinatit të sheqerit.

3. Sektori i tretë ka bazë **infrastrukturën, transportin dhe turizmin.**

Rol të ndjeshëm në zhvillimin e qarkut të Korçës, po merr sektori terciar veçanërisht *infrastruktura, transporti dhe turizmi*. Pozicioni gjeografik i qarkut (nëpërmjet pesë doganave), ofron kontakt të drejtpërdrejtë me Greqinë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Rrjeti rrugor siguron lidhje hapësinore të qendrave urbane me qarqet e tjera dhe vendet fqinjë, sikundër edhe lidhjen me të gjitha komunat. Në infrastrukturën rrugore janë bërë investime dhe përmirësime në rrugët që lidhin qytetin e Korçës me qendrat turistike si: Pogradecin, Voskopojën, Dardhën, Liqenas, pikën turistike të Moravës etj. Përmirësimet në infrastrukturë kanë lehtësuar jo vetëm shfrytëzimin e burimeve natyrore por kanë nxitur zhvillimin e turizmit në zonat malore me interes të veçantë. Megjithatë, zhvillimi i turizmit kërkon me domosdoshmëri një infrastrukturë me standarte bashkëkohore, që mundëson arritjen e destinacioneve në kohë reale. Gjithashtu, funksionimi i një aeroporti kombëtar dhe rajonal, si edhe ekzistenca e një pike portuale në liqenin e Ohrit, përveçse impaktit pozitiv në zhvillimin ekonomik, do të lehtësonin lëvizjen e udhëtarëve për qëllime turistike. Distanca e afërt me qytetet e Selanikut dhe Kozanit në Greqi, Ohrit dhe Shkupit në FYROM, po kështu edhe me aeroportet e qyteteve kryesore të Europës Lindore, do t'a lehtësonte lëvizjen e njerëzve dhe përmbushjen e qëllimeve të tyre turistike. Shërbimi i telefonisë fikse në qarkun e Korçës sigurohet nga Albtelekom, si dhe tre operatore privatë, që operojnë kryesisht në zonat rurale, ndërsa telefonia celulare mundësohet nga shërbimi i dy kompanive, AMC, Vodafon, Eagle, duke

siguruar sinjal të pandërprerë.

Faktorët pozitivë	Mundësitë e zhvillimit
Shtrirja Gjeografike (kufi me dy shtete)	Zhvillimi i turizmit
Infrastruktura e mire ne rajon	Kthimi i emigranteve (potencial njerezor)
Burime te mjaftueshme njerezore	Zhvillimi i agrobiznesit (perpunues)
Qytet Universitar	Prezenca e donatoreve potenciale ne Korce.
Mirefunksionimi i Qeverisjes Vendore	Bashkepunime cross-border
Sistem Bankar	Te ardhurat per fryme te larta
Burime Natyrore te mjaftueshme	Bashkepunim i Pushtetit Lokal, Biznesit
Larmi Biznesesh	dhe
Kanalizimi i ujerave te bardha e te zeza	Komunitetit
Egzistenca e tradites dhe vlerave kulturore	Promovimi i traditave
Emigracioni (te mesuarit e profesioneve)	Zhvillimi i turizmit familjar
Besueshmeria tek donatoret	